

BANKA E SHQIPËRISË**TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQËRUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATËVE TË HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje sistem automatik i paketimit me plastmas të kartëmonedhave për nevojat e Bankës së Shqipërisë”.

“Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 17,511,600 Lekë”.

Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- b. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë (Ish-Hotel Dajti), Tel: 042 419 411, (ext: 214), çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Blerje sistem automatik i paketimit me plastmas të kartëmonedhave për nevojat e Bankës së Shqipërisë”; ose

- c. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: avaraku@bankofalbania.org.

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qëndrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë (Ish-Hotel Dajti), deri më datë 08 Korrik 2026, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 63, datë 08.10.2021 “Për miratimin e kritereve të punësimit të personelit administrative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të

Administrimit nr. 26, datë 18.04.2024 Për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 63, datë 08.10.2021 “Për miratimin e kriterëve të punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” si dhe në Urdhrin e Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me nr. , datë __.05.2026 “Për fillimin e procedurës së punësimit për pozicionin e punës personeli administrativ “Specialist” në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë” shpallet konkursi për 1 (një) vend të lirë pune, si më poshtë:

A. Përshkrimi përgjithësues i punës:

- Ushtron veprimtarinë në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, Vendimin nr. 345, datë 01.06.2004 “Për miratimin e procedurave të auditimit, Kodit të Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik”;
- Kontrollon menaxhimin dhe përdorimin me efektivitet të fondeve dhe përmirësimin e veprimtarisë të UMT-së dhe njësive shpenzuese;
- Kryen auditime të përgjithshme për politikën dhe procedurat, kryen analiza sipas orientimeve;
- Përgatit raportet për auditimet e kryera.

B. Kushtet dhe kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar me këtë zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
3. Të zotëroj aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilën konkurron;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
6. Të ketë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
7. Audituesi i Brendshëm duhet të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”;
8. Nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si auditues i brendshëm, gjatë 3 vjetëve të parë punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimit të procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”; Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjës nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen që janë ndërprerë për shkak të këtij ligji;
9. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
10. Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra;
11. Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës.

C. Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;

4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për ciklet përkatëse të studimit);
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetimi i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
7. Dëshmi penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit;
8. Formular vetëdeklarimi kërkuar nga ligji nr.138/2015;
9. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit në kohë, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
11. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të noterizuar;
12. Certifikatë/Dëshmi të noterizuar që vërtetojnë njohuritë kompjuterike në programet bazë;
13. Dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar origjinal ose të njehsuar me origjinalin (të inventarizuar), pranë zyrës së Protokoll Arkivës, në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë).

Mosdorëzimi i dokumentacionit të plotë të kërkuara më sipër apo dorëzimi jo në formën e specifikuar, sjell skualifikim të kandidatit.

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga shpallja e njoftimit në buletin e APP-së.

D. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Njohuri të akteve nënligjore në fuqi për fushën e auditimit;

E. Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Për çdo paqartësi mund të kontaktoni në adresën info@umed.edu.al

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. , datë .05.2026 “Për miratimin e kritereve dhe fillimin procedurës së punësimit për pozicionin e punës personel ndihmës akademik “Sekretare Mësimore” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, shpallet konkursi për 1 (një) vend të lirë pune “Sekretare Mësimore”, me përcaktimet si më poshtë:

A. Kriteria të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të ketë përfunduar ciklin e studimeve universitare të nivelit Bachelor dhe Master Profesional/ Master Shkencor apo të barasvlefshëm me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të zotërojë me dëshmi një nga gjuhët perëndimore (Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht, Gjermanisht);
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office.

B. Kriteria preferenciale:

1. Të ketë eksperiencë pune 1 (një) vjeçare.

C. Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass) i përditësuar;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimet e tyre në MA (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;

7. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së programeve bazë kompjuterike;
8. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
9. Dëshmi penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit;
10. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”;
11. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
12. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit në kohë, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar (të inventarizuar), sipas përcaktimeve të mësipërme, në Zyrën e Protokollit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, brenda QSUNT, Tiranë).

Mosdorëzimi i dokumentacionit të plotë të kërkuar më sipër apo dorëzimi jo në formën e specifikuar, sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes në buletin e APP-së.

D. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Njohuri mbi praktika administrative.

E. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. ____, datë ____.05.2026 “Për fillimin procedurës së punësimit për pozicionin e punës personel akademik të kategorisë Profesor, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, shpallet konkursi për 1 (një) vend të lirë pune personel akademik me kohë të plotë, në Departamentin e Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me përcaktimet si më poshtë:

D. Kriteria të përgjithshme:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë diplomuar në Degën Mjekësi e Përgjithshme;
5. Të zotërojë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”;
6. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron;
7. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
8. Të zotërojë me dëshmi një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht;
9. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
10. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna nga institucione të edukimit;
11. Të ketë licencë për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga Urdhri përkatës (Mjekut).

E. Kriteria preferenciale:

- Të kete pervojë pune dhe eksperiencë në mësimdhënie të paktën për një periudhë kohore 5 (pesë) vite, e dokumentuar;
- Të ketë publikime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca mjekësore brenda dhe jashtë vendit;
- Të ketë pjesëmarrje dhe përvojë në projekte kërkimore-shkencore.

F. Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass) i përditësuar;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimet e tyre në MA (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Dëshmi (fotokopje të noterizuara) të titujve Profesor / Profesor i Asociuar. Për dëshmitë e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MA);

6. Kopje e noterizuar e licencës për ushtrim individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri përkatës (Mjekut);
7. Të paktën dy referenca nga profesorë të Fakultetit dhe/ose referenca nga punëdhënës të mëparshëm;
8. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
9. Vërtetim i aftësisë për punë, i vlefshëm për tre muajt e fundit nga data e aplikimit për vendin e punës;
10. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;
11. Dëshmi penaliteti (lëshuar brenda 3- muajve të fundit nga data e aplikimit);
12. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015;
13. Vetëdeklarim mbi mosmarrjen ndaj tyre të masave disiplinore të largimit nga puna nga institucione të edukimit;
14. Çdo dokument tjetër që provon punësimin si pedagog i brendshëm apo i jashtëm, trajnimet, arsimin shtesë, artikujt, tekstet, revistat, projektet shkencore, vlerësimet pozitive apo të tjera të kërkuara nga kriteret specifike dhe/ose preferenciale apo të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar (të inventarizuar), sipas përcaktimeve të mësipërme, në Zyrën e Protokollit në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë).

Mosdorëzimi i dokumentacionit të plotë të kërkuar më sipër apo dorëzimi jo në formën e specifikuar, sjell skualifikim të kandidatit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes në buletin e APP-së.

F. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Njohuri mbi fushën e formimit profesional si dhe ushtrimit të mësimdhënies.

G. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Për çdo paqartësi kandidatët mund të dërgojnë e-mail në adresën info@umed.edu.al

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr.____, datë ____05.2026 “Për fillimin procedurës së punësimit për pozicionin e punës personel akademik “Lektor” në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, shpallet konkursi për 1 (një) vend të lirë pune “Lektor” me kohë të plotë, në Departamentin e Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji, Infermieristikës në Obstetrik Gjinekologji, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, me përcaktimet si më poshtë:

A. Kriteria të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë diplomuar në degën Mjekësi e Përgjithshme ose Infermieri;
- Të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor”;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurron;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të zotërojë me dëshmi një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna nga institucione të edukimit;
- Të ketë licencë për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga Urdhri përkatës (Mjekut/Infermierit).

B. Kriteria preferenciale:

- Të ketë përfunduar studimet në programin/et e logopedisë;
- Të ketë eksperiencë mësimdhënie kombëtare apo ndërkombëtare në programe studimi të logopedisë;
- Të ketë eksperiencë pune klinike në fushën e logopedisë;
- Të ketë aktivitet shkencor kombëtar apo ndërkombëtar në fushën e logopedisë;

- Të ketë kurse dhe trajnime kombëtare apo ndërkombëtare në fushën e logopedisë.

C. Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass) i përditësuar;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimet e tyre në MA (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Diplomë (fotokopje të noterizuar) të gradës shkencore “Doktor”/ “PHD” të fituara jashtë RSH. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MA);
6. Kopje e noterizuar e licencës për ushtrim individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri përkatës (Mjekut/Logopedit);
7. Të paktën dy referenca nga profesorë të Fakultetit dhe/ose referenca nga punëdhënës të mëparshëm;
8. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
9. Vërtetim i aftësisë për punë, i vlefshëm për tre muajt e fundit nga data e aplikimit për vendin e punës;
10. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së gjuhës së huaj;
11. Dëshmi penaliteti (lëshuar brenda 3- muajve të fundit nga data e aplikimit);
12. Formular vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga ligji nr.138/2015;
13. Vetëdeklarim mbi mosmarrjen ndaj tyre të masave disiplinore të largimit nga puna nga institucione të edukimit;
14. Çdo dokument tjetër që provon punësimin si pedagog i brendshëm apo i jashtëm, trajnimet, arsimin shtesë, artikujt, tekstet, revistat, projektet shkencore, vlerësimet positive apo të tjera të kërkuara nga kriteret specifike dhe/ose preferenciale apo të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar (të inventarizuar), sipas përcaktimeve të mësipërme, në Zyrën e Protokollit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, brenda QSUNT, Tiranë).

Mosdorëzimi i dokumentacionit të plotë të kërkuar më sipër apo dorëzimi jo në formën e specifikuar, sjell skualifikim të kandidatit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes në buletin e APP-së.

D. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Njohuri mbi fushën e formimit profesional si dhe ushtrimit të mësimdhënies.

E. Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Për çdo paqartësi kandidatët mund të dërgojnë e-mail në adresën info@umed.edu.al

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Njoftim për vend të lirë pune

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. , datë .05.2026 “Për miratimin e kritereve dhe fillimin e procedurës për pozicionin e punës personel ndihmës akademik “Laborante Mësimore”, në Departamentin e Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, shpallet konkursi për pozicionin e punës, personel ndihmës akademik “Laborante Mësimore” në Departamentin e Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë me përcaktimet si më poshtë :

A. Kriteria të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurren;
- Të ketë përfunduar ciklin e studimeve universitare të nivelit “Bachelor” dhe “Master i Shkencave” apo të barasvlefshëm me to, sipas kuadrit ligjor të arsimit të lartë;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;

- Të zotërojë me dëshmi një nga gjuhët perëndimore (Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Italisht, Gjermanisht);
- Të ketë njohuri të përdorimit të programeve bazë kompjuterike;
- Të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar sipas ligjit;
- Të ketë eksperiencë pune të mëparshme të dokumentuar;

B. Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass) i përditësuar;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MA (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listën e notave të noterizuara (për secilin program përkatës studimi);
5. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Vërtetim i gjendjes shëndetësore të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit (raport mjekësor për aftësinë në punë);
7. Dëshmi penaliteti të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit;
8. Formular vetëdeklarimi kërkuar nga ligji nr.138/2015;
9. Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi (për kandidatët që janë në marrëdhënie pune);
10. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
11. Kopje e noterizuar e dëshmisë së njohjes së paketës Microsoft Office;
12. Kopje e noterizuar e dokumentacionit që provon njohjen e gjuhës së huaj;
13. Referenca nga punëdhënës të mëparshëm ose eprori direkt, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar të inventarizuar, origjinal ose të njehsuar me origjinalin, në Zyrën e Protokollit, në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë (Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë).

Mosdorëzimi i dokumentacionit të plotë të kërkuar më sipër apo dorëzimi jo në formën e specifikuar, sjell skualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga shpallja e njoftimit në buletin e APP-së.

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri mbi Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;

– Njohuri mbi praktika administrative.

Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@umed.edu.al

UNIVERSITETI I TIRANËS, FILIALI SARANDË **Njoftim për vend të lirë pune**

UNIVERSITETI I TIRANËS, FILIALI SARANDË, shpall konkursin për 1 (një) vend të lirë pune për personel akademik, me kohë të plotë të kategorisë “Asistent Lektor” në Degën, Gjuhë Angleze. Kandidatët konkurrentë për pozicionin vakant Personel Akademik me kohë të plotë të kategorisë “Asistent Lektor” në Degën e Gjuhës Angleze, në Universitetin e Tiranës, Filiali Sarandë, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

❖ Kriteret të përgjithshme:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta të nivelit “Master i Shkencave” ose të kenë diplomë universitare DIND (Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë), në Gjuhë Angleze.
2. Të kenë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve, Bachelor me notë mesatare mbi 8 (tetë), Ciklin e Dytë të studimeve, Master i Shkencave, me notë mesatare mbi 8 (tetë), ose të kenë diplomë universitare DIND (Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë), me notë mesatare mbi 8 (tetë).
3. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një gjuhë të huaj nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Europian: frenge, gjermane, italiane, spanjolle, greke.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e nje vepre penale me dashje.